





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. 491 / Data 01/08 /2022.

Kamenicë

Në mbështetje të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 neni 62 pika 3, Rregullores Komunale për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve Nr. 39305 të datës 12.12.2016 neni 5,19,20 dhe planit të punës për vitin 2022, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural shpall :

THIRRJE PËR APLIKIM (Për fermerët - Prodhues të Qumështit)

Njoftohen të gjithë fermerët e Komunës së Kamenicës të cilët janë prodhues të qumështit, se Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Komuna do të bëjë subvencionimin e prodhuesve të qumështit për sasi / litër, të cilët dorëzojnë qumësht në pikat grumbulluese dhe qumështore për gjashtë mujorin e parë (6M-1) Janar- Qershor 2022 me nga 0.05 €/ litër.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Letërnjoftimi i R. së Kosovës (kopje);
2. Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
3. Dëshminë nga pika grumbulluese - qumështorja për sasinë e qumështit të dorëzuar për periudhën Janar- Qershor 2022;
4. Dëshmi e pagesës bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar);
5. Kopja e kontratës, e vërtetuar nga noteri për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret ose pikat grumbulluese të qumështit në Kosovë;
6. Vërtetimi i Tatimit në pronë,
7. Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK. me informata (vetëm për persona juridik);
8. Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-ës (vetëm për persona juridik);
9. Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për persona juridik);
10. Çertifikata e fermerit (NIF).

- ✓ Aplikacioni merret në Drejtorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- ✓ Aplikacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën për Shërbime me Qytetarë (QSHQ).

Afati për aplikim është prej datës 01.08.2022 deri më datë 19.08. 2022.

